



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO  
AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU - PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Rr. Ilir Konushevci Nr.8 ♦ Prishtinë ♦ Kosovë Tel: ++381 38 500 400 0 Fax: ++ 381 38 248 076 E-mail: [info@pak-ks.org](mailto:info@pak-ks.org)  
[www.pak-ks.org](http://www.pak-ks.org)

Lista përfundimtare e punëtorëve të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të të hyrave, sipas nenit 10 të rregullores së UNMIK-ut 2003/13 (me ndryshime)

### NSH. “KB Turiqevci” (MIT011), Fi 1419/90 në Skenderaj-Mitrovicë

Sipas nenit 10 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 (me ndryshime), 20% e të hyrave nga shitjet prej privatizimit dhe likuidimit të NSH-së së lartpërmendur do t’u shpërndahet punëtorëve të NSH-së të cilët i plotësojnë kushtet e parapara.

Në vijim është dhënë lista e personave të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të 20 % prej të hyrave nga shitja dhe përvoja e tyre e punës:

| Mbiemri | Emri     | Vite pune | Mbiemri   | Emri     | Vite pune | Mbiemri | Emri    | Vite pune |
|---------|----------|-----------|-----------|----------|-----------|---------|---------|-----------|
| Aliu    | Hasan    | 19,98     | Haliti    | Muharrem | 19,15     | Nika    | Valbona | 20,48     |
| Gecaj   | Adem     | 31,71     | Isufi     | Haxhi    | 29,23     | Osmani  | Nezir   | 26,65     |
| Geci    | Musli    | 19,98     | Kallamaku | Sevdije  | 27,15     | Rushiti | Imer    | 19,98     |
| Halimi  | Abedin   | 12,51     | Kastrati  | Nezir    | 19,60     | Thaqi   | Refki   | 14,90     |
| Halimi  | Xheladin | 24,56     | Muslija   | Qamil    | 29,15     | Zekaj   | Jahir   | 4,08      |

Sipas nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 (me ndryshime), punëtori ka të drejtë të marrë një pjesë të 20 % të të hyrave nga shitja nëse ai/ajo ka qenë i evidentuar si punëtor i NSH-së së lartpërmendur në kohën e privatizimit ose likuidimit (cilado që ka ndodhë më parë) dhe që ka qenë në listën e pagave të NSH-së të paktën për tri vite. Punëtori i cili nuk e plotëson këtë kriter megjithatë mund të ketë të drejtë nëse diskualifikimi i tij/saj është bërë në bazë diskriminuese.

Secili person i cili mendon se ai/ajo do të duhej të jetë përfshirë në listë, që dëshiron ta kundërshtoj një ose më shumë emra në listë, ata të cilët mendojnë se stazhi i tyre i punës nuk është i saktë ose dëshirojnë të bëjnë ankese lidhur me mënyrën e shpërndarjes së fondeve sipas nenit 10.5 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 (me ndryshime), atëherë secili prej tyre mund të parashtrorjë ankesë në Odën e Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës në pajtim me nenin 64.6 të Urdhëresës Administrative Nr. 2006/17 në lidhje me Rregullat e Procedurës së Odës së Veçantë. Ankesa duhet të behet me shkrim dhe duhet të përmbaj (1) emrin (emrat) e individit (individëve) në emër të të cilit është parashtruar ankesa (parashtruesi (parashtruesit e ankesave); (2) adresën e parashtruesit (parashtruesve) të ankesës dhe (3) arsyet e detajuara faktike dhe ligjore për parashtrimin e ankesës me dëshmi plotësuese (në rastet kur janë të aplikueshme), kurse kopjet e dokumenteve duhet të jenë të vërtetuara nga organi kompetent. Kur ankesa është parashtruar në emër të parashtruesit (parashtruesve) të ankesës nga pala e tretë (p.sh avokati), pala e tretë duhet ta siguroj autorizim me shkrim me të cilin vërtetohet se është i autorizuar për të vepruar në emër të parashtruesit (parashtruesve) të ankesës.

Ankesat duhet të parashtrohen në Odën e Veçantë në këtë adresë:

Oda e Veçantë e Gjykatës Supreme të Kosovës

Rr. Nazim Gafurri nr. 31

10000 Prishtinë,

Kosovë

**Të gjitha ankesat në lidhje me këtë njoftim duhet të dorëzohen deri më datën 20 gusht 2011 para përfundimit të orarit të punës së të njëjtës ditë**

Për informata shtesë lidhur me atë se si duhet të parashtrorhet ankesa, ju rekomandojmë që ju apo avokati juaj të shikoj nenin 10 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 (me ndryshime), Kaptinën e V të Urdhëresës Administrative Nr. 2006/17 ose të kontaktoni Odën e Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës.